

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Studimi i Qendrës Evropiane, vende më të prekura nga salmonela në Evropë
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/12/studimi-i-qendres-evropiane-vende-me-te-prekura-nga-salmonela-ne-evrope/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:21:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 09:54:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3684739eebb249e8e4dde2c005eb55164b73963896be0045293e492c2306c484
TEKSTI	3e0ee2f0873721969587843190f82dbd305e77674469d00dba49a5254e7603b6
PAMJA	d4616453fbc7a2facff3bd50ed182bab081cda08ae9a7c7ef8b58cfa00868368

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f02391db9f5068576616794e1110da300e4800bc3c27d76f5bad2a4dc8d73f13
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f02391db9f5068576616794e1110da300e4800bc3c27d76f5bad2a4dc8d73f13>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

S tudimi i Qendrës Evropiane, vende më të prekura nga salmonela në Evropë

Botë

Publikuar: 12/09/2026

f X



Salmonela vijon të përbëjë një shqetësim për shëndetin publik në Evropë, ndërsa autoritetet shëndetësore kanë raportuar një numër të konsiderueshëm rastesh dhe shpërthimesh të lidhura me ushqimet.

Të dhënat e publikuara nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) tregojnë se rastet e salmonelozës kanë ardhur në rritje që prej vitit 2020. Në fokus të veçantë janë fëmijët e vegjël, veçanërisht ata nën moshën katër vjeç.

Gjatë periudhës maj 2025–gusht 2026, në kuadër të shpërthimeve të hetuara në Evropë u konfirmuan 341 raste. Mbretëria e Bashkuar kryesonte me 207 raste, e ndjekur nga Holanda me 106. Belgjika raportoi 15 raste, ndërsa në Gjermani u regjistruan 6, në Francë 4, në Austri 2 dhe në Danimarkë 1.

Shifrat për Mbretërinë e Bashkuar u rishikuan më pas, duke e çuar në 474 numrin e rasteve të lidhura me shpërthimin. Hetimet vijnë, ndërsa dyshimet janë përqendruar edhe te konsumimi i ushqimeve jashtë shtëpisë.

Gjermania, Franca dhe Spanja me numrin më të lartë të rasteve

Në të dhënat e përgjithshme për Bashkimin Evropian gjatë vitit 2024, Gjermania rezultoi me numrin më të madh të rasteve të raportuara, me 12,316 raste. Pas saj renditet Franca me 12,308 raste, ndërsa Spanja raportoi 11,248 raste.

Në anën tjetër, numri më i ulët i rasteve u raportua në Qipro, me 80 raste, Estoni me 103 dhe Maltë me 164.

Me të lexuarat

Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Besnik Leskaj...

Besnik Leskaj i mori në punë të birin. Postet në merrshmi i administratës së...

Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik të kokainës dhe Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë...

biznesmenit Enri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Enri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Ekspertët theksojnë se diferencat mes vendeve nuk lidhen domosdoshmërisht vetëm me përhapjen e bakterit. Ato mund të ndikohen edhe nga mënyra se si kryhen testimet, raportimi i rasteve dhe hetimet epidemiologjike në secilin shtet.

Vezët dhe ushqimet e tjera në qendër të hetimeve

Një nga shpërthimet më të rëndësishme të raportuara së fundmi ka ndodhur në Belgjikë, ku më shumë se 300 persona u sëmurën pas konsumimit të vezëve.

Por vezët nuk janë i vetmi ushqim i lidhur me rastet e salmonelës. Në hetime janë përfshirë edhe makarona, fara kungulli, produkte të qumështit dhe ushqime me bazë shpendësh.

Salmonela transmetohet kryesisht përmes ushqimit të kontaminuar. Rreziku rritet veçanërisht nga konsumimi i mishit, shpendëve dhe vezëve të pagatuara mirë, si dhe nga produktet e qumështit të papasterizuara.

Simptomat dhe grupet më të rrezikuara

Infeksioni zakonisht shkakton diarre, temperaturë, dhimbje barku dhe të përziera. Në shumicën e rasteve, simptomat largohen brenda rreth një jave.

Megjithatë, salmoneloza mund të jetë më e rrezikshme për fëmijët e vegjël, të moshuarit dhe personat me sistem imunitar të dobësuar.

Në Bashkimin Evropian raportohen çdo vit më shumë se 91 mijë raste të salmonelozës, ndërsa ndikimi ekonomik i infeksioneve vlerësohet deri në 3 miliardë euro në vit, duke përfshirë kostot mjekësore, hospitalizimet dhe humbjet e produktivitetit.

Autoritetet shëndetësore vijojnë të rekomandojnë respektimin e rregullave të higjienës, ruajtjen e ushqimeve në temperaturat e duhura dhe gatimin e plotë të produkteve ushqimore si masa kryesore për uljen e rrezikut të infektimit.

/pamfleti

TAG:

Aku

Salmonela

Të ngjashme





Angli/ Dënohet agjenti imobilar, i siguroi shqiptarëve 19 shtëpi për të mbjelle kanabis me vlerë dy milionë sterlina



Tri humbje dhe më afër fitores se kurrë: Pse 2027 mund të jetë viti i Marine Le Pen



Atentati ndaj aeroportit gjerman/ Gjurmët që çojnë drejt shërbimit sekret rus

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.